



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:223910
Datë: 23.10.2024
Numri i dokumentit: 06336771

Ac.nr.5941/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Naime Ahmeti - kryetare e kolegjit, Naim Mehollli dhe Halide Reka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Xh.D. nga Gjilani, të cilën me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “K.& A.”, kundër të paditurit Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, me seli në Prishtinë, për pagesën e shpërblimeve jubilarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.8046/2021, të datës 14.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e të paditurit Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.8046/2021, i datës 14.06.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.8046/2021, të datës 14.06.2023, ka aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Xh.D. nga Gjilani, dhe ka detyruar të paditurën Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite përvojë pune t’ia paguaj vlerën e dy pagave bazë në shumën prej 1,203.36€, së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 8%, e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë datë 06.10.2021 e gjerë në pagesën definitive, si dhe në emër të shpenzimet e procedurës kontestimore shumë prej 394.00€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e të paditurës, të ndryshoj aktgjykimin C.nr.8046/21 të datës 14.06.2023, duke refuzuar padinë e paditëses si të pabazuar.

I autorizuari i paditëses me përgjigje në ankesë, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe të vërtetohet në tërësi aktgjykimi i atakuar, si dhe të detyrohet e paditura për përpilimin e përgjigjes në padi në shumë prej 208.00 euro.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja ka ushtruar padi në gjykatën e shkallës së parë me datë 06.10.2021, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që lidhur me pagesën e shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës së punës t ia paguaj vlerën e një page baze dhe atë në shumën prej 940 euro me kamatë ligjore si dhe t ia kompensoj shpenzimet e procedurës. Me parashtresën e datës 15.05.2023, paditësja ka bërë precizimin e padisë duke kërkuar shumën prej 1,203.36 euro. Përgjigje në padi ka ushtruar e paditura duke propozuar që gjykata ta refuzoj në tërësi padinë e paditëses si të pabazë.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditëses, përgjigjes në padi të dhënë nga e paditura pas vlerësimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqës, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm përkitazi me vendosjen si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në shkeljet nga nenit 182 paragrafi 2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike apo atë e ka paraqitur në mënyrë jo të plotë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë, bazuar në shkresat të cilat i ka pasur në dispozicion, Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe disa fakte vendimtare nuk kanë qenë kontestuese. Nuk ka qenë kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune me të paditurën në, me detyrat e punës: si teknike laborante, fakt i vërtetuar me kontratën e punës me nr. protokollit 188, të datës 04.02.2013. Po ashtu nuk ka qenë kontestues se paditësja ka përvojë punës, ku nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet fakti se paditësja ka mbi 20 vjet përvojë pune dhe realizon pagë bazë mujore në lartësi prej 601.68 euro.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka aplikuar edhe të drejtën materiale, për arsye se me: dispozitën e nenit 67 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L -212 datës 01.11.2010, përcaktohet se *Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndemjet a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve*. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: *Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: në a) nivel të vendit, b) në nivel të degës, c) nivel të ndërmarrjes*. Me paragrafin 3, të këtij neni përcaktohet se *“Marrëveshja duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Ndërsa me paragrafin 4 përcaktohet se: *Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*.

Me dispozitën e nenit 17 paragrafi 3 pika 3.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale, është e paraparë se: *“Punëtorët shëndetësor në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i tyre i fundit, për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një pagave mujore të tij”*, dhe në paragrafin 4 të Kontratës Kolektive Sektoriale parashihet se: *“Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë, Shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”*.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë, duke e detyruar të paditurën që paditëses për mbi 20 vite përvojë pune, t’ia paguaj dy paga mujore në shumë prej 1,203.36 euro, në emër të shpërblimit jubilar, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të nënshkruar nga Qeveria-Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi nga data 11.06.2018 dhe e njëjta është e zbatueshme, e cila është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës.

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë nuk është obligative për të paditurën, meqenëse nënshkruerit e kësaj kontrate siç janë Ministria e Shëndetësisë dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që kanë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive Sektoriale, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura e në përputhje me gjendjen faktike të vërtetuar në procedurë, për kërkesën e aprovuar në shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është e mendimit se e njëjta është adekuate, duke pas parasysh dispozitën e nenit 17 paragrafi 3 pika 3.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, Nr.05-3815 të datës 12.06.2018. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëses, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozita e LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odes së Avokatëve dhe tarifat

për shpenzime gjyqësore. E drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë edhe sa i përket kërkesës aksesore përkitazi me kamatën.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës 195.1, pika d) lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykim.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.5941/2023, me datë 22.10.2024

**Kryetarja e Kolegjit,
Naime Ahmeti**